



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 523/5 Prot

Tiranë, më 25/6/2015

V E N D I M

Nr. 27, datë 25/6/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "C&D VOICE" sh.p.k.,

V Ë R E J S E:

Në zbatim të Urdhrit nr. 121, datë 29/05/2015 është kryer hetim administrativ pranë subjektit kontrollues "C&D VOICE" sh.p.k, me objekt: Plotësimi i detyrimit për të njoftuar në zbatim të nenit 21, të ligjit nr.9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të aktivitetit mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale për subjektet e të dhënave të cilët kanë lidhje me aktivitetin e tij. Nga hetimi administrativ i ushtruar pranë kontrolluesit rezultoi se "C&D VOICE" sh.p.k nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit (neni 21). Për shkeljen e konstatuar është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të kontrollit administrativ. Kontrolluesi ka deklaruar se: "nuk ka patur dijeni për këtë detyrim ligjor".

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar si dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", data 19/06/2015 ishte caktuar për tu realizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Kontrolluesi "C&D VOICE" sh.p.k është informuar për datën dhe orën e seancës dëgjimore nëpërmjet shkresës nr. 523/3 prot. dt. 09/06/2015. Kontrolluesi "C&D VOICE" sh.p.k nuk u paraqit në datën e përcaktuar dhe njoftuar për seancën dëgjimore.

Pretendimi i përfaqësueses së kontrolluesit sipas së cilës nuk kishte dijeni për ligjin nuk qëndron, pasi ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, është miratuar dhe botuar në Fletoren Zyrtare dhe me kalimin e afatit ligjor përkatës, është bërë i njohur për të gjithë publikun dhe është i detyrueshëm për zbatim. Nga miratimi i këtij ligji deri në momentin e ushtrimit të këtij hetimi administrativ ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe kontrolluesi ka patur gjithë mundësinë për t'u njohur me ligjin dhe detyrimet e tij, për më tepër që ka lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetin e tij.

Subjekti kontrollues "C&D VOICE" sh.p.k sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit është krijuar dhe ushtron aktivitetin e tij që prej datës 30.05.2014, mosnjohja e ligjit nuk përbën shkak ligjor për përjashtimin nga përgjegjësia e përbushjes së detyrimeve të tij.

Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: "*...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji*".

Gjithashtu, bazuar në nenin 25/1 të ligjit të sipërcituar, parashikohet që kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë zyrën e Komisionerit. Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale, pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë, në Regjistrin Qëndror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja "d" të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbën "**kundërvajtje administrative**" dhe sanksionohet me gjobë, si më poshtë:

- Kontrolluesit, që nuk përbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 500 000 lekë.

Personat juridikë, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, ajo lidhet me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për t'u informuar se kush përpunon të dhëna personale, informimin si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parim bazë i mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ si edhe reagimin e kontrolluesit për rikuperimin e shkeljes së konstatuar.

PËR KËTO ARSYE

Në zbatim të neneve 21, 30, 31, 32/1, 39/1/d, 39/2, 40 dhe 41 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit "C&D VOICE" sh.p.k me gjobë në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyre të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, në afatet dhe sipas procedurave që rregullojnë gjykimin administrativ, në përputhje me nenin 40 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot në 25/06/2015

